



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



|   |          |          |       |                 |
|---|----------|----------|-------|-----------------|
| I | Data     | 28.03.22 | Vendi | KAÇANIK         |
|   | Nj. org. |          | Numri |                 |
|   |          | 01       |       | 105/02-20838 -1 |



Republika e Kosovës

Komuna e Kaçanikut

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)–

01.Nr. zyrtar/ 2022

### Procesverbal

**Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2022**

**Më 07.06.2022**

Në takim prezantuan:

**Besim Ilazi, Kryetar i Komunës**

**Sabedin Vishi, Nënkyetar i Komunës**

**Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik**

**Fatmir Qaka, EVSB**

**Shemsedin Abazi-KLSP**

**Elmihane Malsiu-HANDIKOS**

**Fidaim Fazliu, Bashkësia Islame**

**Fadil Guri, ZKKK**

**Vedat Dema, Zyra për të Drejtat e Njeriut**

**Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal**

**Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale**

**Ylber Tusha-Përfajqsuesi i Bizneseve**

**Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve**

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i prosesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Shqyrtimi i dukurive negative
- 4.Monitorimi dhe raportimi i gjendjes së sigurisë dhe zbatimi i planit për siguri në shkolla
- 5.Përgatitja , dhe vetdijsimi i qytetarëve për parandalimin e zjarreve në sezonin verorë
- 6.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

## **2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut**

Për gjendjen e sigurisë në Komunën tonë raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë **Halim Shehu** i cili tha se situata e sigurisë në periudhën në mes të dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile por që i kemi gjithsejtë 40 raste të veprave penale ku prej tyre rast më prekës ka qenë një vrasje dhe vrasje në tentativë ndërsa rastet tjera nuk kanë qenë të ndonjë natyre që çënon në masë të madhe sigurinë qytetare.

Lëndim i rëndë trupor kemi 3 raste,kanosje-4 raste,dëmtim prone -4 raste, kanosje ndaj personit zyrtarë -2 raste,shkaktim i rrezikut të përgjithshëm -1 rast , sulm-1 rast,vrasje dhe vrasje në tentativë ku për fat të keq një person është i vdekur dhe një i plagosur .Një rast e kemi hyrje në sistemin kompjuterik , bime të dyshuara narkotike kemi një rast,vjedhje -4 raste , vjedhje e rëndë-7 raste, përdorim i armës-1 rast, zjarrvënje-1 rast , vetëvrasje në tentativë-1 rast, falsifikim i parasë-1 rast,mashtrim-1 rast, aksident në trafik-1 rast.

Tri raste i kemi me mungesë të paisjeve për punë në kompanitë e licencuara të ndërtimit.

Stacioni i Policisë i ka disa plane operative dhe aktualisht jemi duke u marrë me pastrimin e parregullsive që janë duke ndodhur nga motorët elektrik dhe skuter.Kjo dukuri është në tërë Kosovën dhe unë kam kërkuar nga zyra ligjore për interpretim ngase kjo dukuri është e re dhe nuk ka kriter për ta shqyrtuar .Një lëndim i lehtë trupor,therrje me thikë, ka ndodhë në oborrin e një shkolle dhe ky rast është përcjellë në organet e drejtësisë.

**Kryetari:** shtimi i rasteve të përdorimit të narkotikëve si shqetësim është ngritë edhe në seancën e fundit të kuvendit komunal dhe në atë seancë është kërkuar që të mbahet një takim me gjithë akterët që të diskutohet kjo problematikë dhe të mirren masa ndaj kësaj dukurie.

**Fadil Guri:**shqetësimet janë të vazhdueshme por që adresimet janë të hezitueshme. Informacionet duhet të plasohen dhe të parandalohet e keqja.Të gjinden forma për të marrë informacione të sakta dhe të veprohet në parandalim duke e adresuar problemin.

**Kryetari:**derisa është ngritë si si çështje problematike përdorimi i narkotikëve në masë të madhe,personi që ka ngritë këtë çështje me siguri se ka ndonjë argument dhe mendoj se është i nevojshëm një takim që është kërkuar dhe të trajtohet kjo çështje.

**Halim Shehu:**pajtohem me parafolësin se problemet duhet të adresohen dhe jo vetëm të flitet se çfar ka dëgjuar.Është e vërtetë se ka rritje të rasteve të përdorimit të narkotikëve por jo në atë masë që flitet.

Kjo çështje problematike është edhe me ligj e klasifikuar.Ka individë që janë individual dhe janë të mvarur prej droge e që dojnë trajtim, dhe ka individë që janë kontrabandues e që ne duhet të i luftojmë ata. Në bashkëpunim me policinë e Ferizajit kemi arritë të i kapim një grup prej 15 personave që janë marrë me kontrabandë të narkotikëve.Personat që janë të mvarur prej substancave narkotike dojnë trajtim por që për fat të keq nuk kemi bërë diçka si shoqëri në hapjen e qendrave për trajtim.Në Ferizaj egziston një qendër trajtuese private që financohet nga donatorë të huaj dhe që po kontribuon në trajtimin e personave që janë të mvarur nga droga.

**Kryetari:**para disa ditëve kam pasur një takim me personin që e ka këtë qendër në Ferizaj dhe në bazë të informacioneve që kanë ata në territorin e komunës tonë ,numri i përdoruesve të narkotikëve është në rritje.Ata janë të interesuar që të hapin një qendër rehabilituese edhe në komunën tonë ngase donatorin e kanë e vetëm lokacioni është në pyetje.Ne si komunë jemi duke e hulumtu edhe formën ligjore për sigurimin e një lokacioni dhe nëse mundësohet atëher vazhdojmë me hapat e më tutjeshëm.

### **3.Shqyrtimi i dukurive negative**

**Kryetari:** kjo temë u diskutua dhe që në takimin që do ta kemi me administratorë dhe qytetarë me siguri që do ta diskutojmë prap.

### **4.Monitorimi dhe raportimi i gjendjes së sigurisë dhe zbatimi i planit për siguri në shkolla**

**Kryetari:**Drejtorin e Arsimit nuk e kemi këtu por që ka shprehë gadishmëri për çdo gjë që ju intereson që të ju jap përgjigje si me shkrim e poashtu përmes ndonjë takimi sa i përket kësaj teme.Besoj se plani për siguri nëpër shkolla egziston dhe drejtorët po mundohen që ta zbatojnë.Problemet kanë ndodhur por që jemi munduar që me nxënës prind e mësimeve përmes takimeve të ndryshme të i zgjedhim .Ka kërkesa të ndryshme për një siguri më të mirë siq është për frekuentimin e policisë në mjediset shkollore por që për shkak të numrit të vogël të zyrtarëve policorë nuk po munden me i mbulu të gjitha pikat.Disa komuna nëpër shkolla kanë edhe kompani të sigurimit fizik por që komunat e vogla nuk e kanë atë mundësi.Policia përmes planeve operative kanë edhe aktivitete vetdijsuese dhe deri më tani kemi pasur një bashkëpunim të mirë në realizimin e këtyre planeve.Shqetësuese është zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër disa fshatra , ku jemi të detyruar të i mbyllim disa shkolla. Ne do të marrim masa në sigurimin

transportit me qëllim që asnjë fëmijë të mos e braktisë shkollimin si shkak i krijimit të këtyre rrethanave.

**Nënkryetari:** kam punuar një kohë të gjatë në arsim dhe mendoj se dukuria e huliganizmit nëpër shkolla ka rënie por që përdorimi i narkotikëve është në rritje. Policia duhet që përmes kontrollave rutinore nëpër shkolla të ndikojë në parandalimin e dukurive negative. Gjithashtu ne po flasim për adresimin e problematikave ndërsa të dhënat e ofruara nuk po mbahen sekret.

**Halim Shehu:** e përmendi edhe Kryetari se ne si polici e kemi një plan operativ për mbajtjen e ligjëratave nëpër shkolla ku trajtohen tema të ndryshme aktuale që shfaqin shqetësim në shoqëri. Ne si polici nuk kemi të drejtë të hyjmë nëpër shkolla dhe të bëjmë kontrolla por që nëse kërkohet nga përgjegjësit e shkollave asistimi ynë atëherë ne jemi aty. Janë rregulla ligjore që çdo institucion gjatë kryerjes së detyrave duhet me me i zbatu konform ligjit. Po e ndërlikohet me procedurën e marrjes në pyetje të dëshmitarëve apo dhënësit të informacioneve ngase është procedurë ligjore juridike. Nëse ipet informacioni për një çështje atëherë ne duhet të hulumtojmë rastin dhe të identifikojmë viktimën.

**Fidaim Fazliu:** shqetësuese unë e shoh përdorimin e lëndëve narkotike sidomos nëpër shkolla fillore. Më brengosë fakti kur dëgjoj se është normale me u përdorë një lëndë narkotike që është më pak e rrezikshme. Në afërsi të shkollave ka shitore dyshuese ngase nxënësit po blejnë cigare me copë por që nuk përjashtohet mundësia që ju ofrojnë edhe gjëra dyshuese. Sigurimi fizik nëpër shkolla është i domosdoshëm dhe mendoj që të gjinden forma që kompanitë e sigurimit të jenë prezent në mjediset arsimore. Është për tu ardhur keq interesimi i prindërve për fëmijët e tyre e që në këtë rast janë vet prindërit që nuk kontribuojnë në rritjen e sigurisë nëpër shkolla.

**Elmihane Malsiu:** sa i përket sigurisë nëpër shkolla edhe pse janë marrë disa masa duke punësuar psikolog, ligjërata nëpër shkolla nga policia dhe takime të ndryshme, mendoj se duhet një angazhim edhe më i madh duke përdorur metoda të ndryshme ngase siguria e nxënësve nëpër shkolla nuk është i kënaqshëm. Propozoj që duke përdorur rrjetet sociale të bëhen anketa të ndryshme që do ta kenë në fokus temat që ne po i diskutojmë këtu. Kjo metodë nuk don kosto dhe besoj se do të ndihmojë sado pak në përmisimin e gjendjes. Rastet nuk duhet anashkaluar siq u raportua se plagosja me armë të ftoftë ka ndodhur duke luajtur. Mjetet e ftofta, të zjarrit apo ndonjë mjet tjetër nuk duhet bartur nga fëmijët.

**Nënkryetari:** ora e kujdestarisë sidomos deri në klasën e nëntë mbahet dhe trajtohen tema nga stafi arsimorë. Është shqetësuese neglizhenca e prindërve për të bashkëpunuar. Duke u bazuar në ligjin mbi arsimin ne nuk kemi të drejtë që nxënësin ta përjashtojmë por si masë duhet ta suspendojmë për një kohë të caktuar. Suspendimi nuk po jep rezultat por që po e ndërlikon procesin arsimorë. Reformat në arsim si duket janë të papërballueshme për ne si shtet i ri që jemi por që angazhimin nuk duhet kursyer për një rend të ri sa i përket kësaj lëmie.

**Jashar Selimi:** gjendja e sigurisë nëpër shkolla mendoj se nuk është e mirë dhe ne si shoqëri në përgjithsi duhet të angazhohemi në preventivë.

## 5. Përgatitja dhe vetdijsimi i qytetarëve për parandalimin e zjarreve në sezonin verorë

Në këtë pikë të rendit të ditës Kryetari fjalën ia dha Drejtorit të Shërbimeve Publike dhe Emergjencës.

**Ramadush Osmani:** komuna ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme në vetdijsimin e qytetarëve në parandalimin e zjarreve, duke bërë njoftime publike nëpër të gjitha pikat kyqe të territorit të komunës sonë, ku në këto njoftime ceken edhe masat që ndërmerren ndaj personave që bëjnë zjarrvënje të qëllimshme dhe të pa qëllimshme. Njësitë e zjarrfikësve ka një plan operativ ku përmes disa pikave vrojtuese përcjellin gjendjen. Ne do të shpërndajmë edhe broshura, njoftime publike në faqen zyrtare të komunës dhe rrjetet sociale për të njoftuar qytetarët për këto masa që do të ndërmerren me qëllim të evitimit të ndonjë situatë të krijuar nga zjarret.

## 6. Të ndryshme

**Jashar Selimi:** po e paraqes një rast mjaftë shqetësues sa i përket sigurisë qytetare. Është fjala për një marshutë që po organizohet nga motoçiklistët nëpër rrugë të ndryshme të komunës tonë ku përdoren edhe automjete të pa regjistruara e çka është më shqetësuese ky aktivitet përcillet nga policia. Ky aktivitet po rrezikon qytetarët dhe mendoj se organizatorët nuk po i përdorin rregullat dhe kriteret e organizimit të ngjarjeve të tilla.

## REKOMANDIMET

1. Të kërkohej interpretim ligjor për qarkullimin e motocikletave me rrymë në komunikacion
2. Angazhim edhe më i madh i akterëve të sigurisë në pengimin e përhapjes së dukurisë së përdorimit të narkotikëve
3. Mos të hezitohet në adresimin e çështjeve që çenojnë sigurinë qytetare
4. Të monitorohet plani i sigurisë nëpër shkollë
5. Angazhim shtesë i stafit mësimor në aktivitete edukuese me nxënës nëpër shkollë
6. Të përdoret forma e anketimeve online në adresimin e çështjeve të sigurisë
7. Të mirren masa ndaj atyre që qëllimisht bëjnë zjarrvënje si dhe të veprohet me kohë në implementimin e planit në parandalimin e zjarreve
8. Të mirren masa ndaj disa organizatorëve që organizojnë marshuta nëpër rrugë me motor e automjete që aq më keq janë pa regjistrim.

Kryesuesi: Kryetari i Komunës

z. Besim Ilazi



Procesmbajtës:

Fatmir Qaka